



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr. 103, datë 24.04.2020

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Z. Lazër Çardaku**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Z. Lazër Çardaku do të ushtrojë funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, përkohësisht nga data 27.04.2020 - 26.07.2020.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Z. Lazër Çardaku do të paguhet me pagën e pozicionit të prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
4. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Z. Lazër Çardaku, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI  
GENT IBRAHIMI

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

